



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORATI

Nr. 1783 Prot

Tiranë më 16.4 2019

VENDIM

Nr. 3, datë 16.04 2019

Bazuar në nenin 40 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 36 të Statutit të Universitetit të Tiranës, Rektorati i Universitetit të Tiranës, pas njohjes me Urdhërin nr.223, datë 12.04.2019 të Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, mori në analizë rekomandimet bazuar në Raportin nr.8359, datë 31.07.2018, të MASR-së, të hartuar nga grupi i punës në zbatim të Urdhrit nr.77, datë 16.02.2018, të MASR-së “Për ngritjen e grupit të punës për kontrollin e pajtueshmërisë së veprimtarisë së UT me aktet ligjore/nënligjore në fuqi”, ku janë pasqyruar problematika që lidhen me drejtimin dhe funksionimin e UT-ës, si dhe me situatën e krijuar, në mbledhjen e tij të datës 16.04.2019 në mënyrë unanime:

VENDOSI

1. Të plotësojë të gjitha rekomandimet e pazbatuara, të dërguara me shkresën e MASR me nr.11215/1prot., datë 07.12.2018.
2. T’i drejtojë menjëherë kërkesë Gjykatës për heqjen e sekuestros konservative për sistemin informatik të UT-së, si një nevojë emergjente për plotësimin e funksionimit normal në shërbim të studentëve dhe personelit akademik, si edhe të tretëve.
3. Vlerëson si një mundësi mjaft të mirë për kërkimin dhe marrjen e informacionit shkencor ekzistencën e bibliotekës digjitale dhe marrjen e masave për përdorimin e saj nga studentët dhe personeli akademik i UT-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

